



Në bazë të nenit 4 të Rregullores për mënyrën, kushtet dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për realizimin e evenimenteve, forumeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit lokal ekonomik nr. 08-775/1 të datës 26.01.2026, në lidhje me Programin e aktiviteteve nga fusha e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit për vitin 2025 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 14/25,3/26 dhe 6/26), Qyteti i Shkupit shpall:

**Thirrje publike
për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit
"Festivali Ritmi i çarshisë"**

1. LËNDA

- 1.1. Lënda e Thirrjes Publike është ndarja e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit "Festivali Ritmi i çarshisë", me qëllim zhvillimin, promovimin, mbështetjen dhe avancimin e zejtarisë dhe tregtisë në territorin e Qytetit të Shkupit.

2. . E drejta për pjesëmarrje në thirrjen publike

2.1. Të drejtë pjesëmarrjeje në Thirrjen Publike kanë të gjitha shoqatat e qytetarëve, fondacionet, federatat, institucionet, shoqëritë tregtare, agjencitë e specializuara për "Mystery Shopping", agjencitë e marketingut, Oda e zejtarëve, shoqatat e qytetarëve dhe klubet e regjistruara në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me seli në Shkup, në përputhje me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

3. 3. Mënyra e shpërndarjes së mjeteve

3.1. Mjetet financiare për realizimin e manifestimit "Festivali Ritmi i çarshisë" janë siguruar në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2026

Shfrytëzimi i mjeteve financiare të ndara do të rregullohet me kontratë të lidhur ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe aplikuesit që i plotëson kushtet themelore dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në Rregulloren për mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për zbatimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit lokal ekonomik.

4. Kriteret themelore dhe të veçanta

Kriteret themelore dhe të veçanta, si dhe mënyra e vlerësimit me pikë për përzgjedhjen e aplikantëve, janë të përcaktuara në Rregulloren për mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën e ndarjes së mjeteve financiare për zbatimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, nr. 08-775/1, datë 26.01.2026, e publikuar në faqen zyrtare të internetit të Qytetit të Shkupit.

5. . Dokumentacioni i kërkuar që aplikanti duhet ta dorëzoj me kërkesën

5.1. Për pjesëmarrje në Thirrjen publike, aplikanti detyrimisht duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë e plotësuar me shkronja të shtypura në shkrimin cirilik, e nënshkruar nga personi përgjegjës dhe e vulosur me vulën e aplikantit (kërkesa do të publikohet në faqen e internetit të qytetit të Shkupit: www.skopje.gov.mk);
- Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose Vendimi për regjistrimin e personit juridik me seli në Shkup;
- Deklaratë e nënshkruar për shlyerjen e detyrimeve ndaj qytetit të Shkupit (tatimi, taksa komunale);
- Vërtetim që nuk ka ndalim për pjesëmarrje në procedura për thirrje publike, dhënien e kontratave për furnizim publik dhe kontrata për partneritet publiko-private (Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut);
- Propozim projekti i përgatitur me shkronja të shtypura në shkrimin cirilik;
- Plan financiar i plotësuar me shkronja të shtypura në shkrimin cirilik.

6 Dokumentacioni shoqërues

6.1. Aplikantët, së bashku me kërkesën, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- biografi profesionale e personelit të kualifikuar që do të angazhohet në realizimin e manifestimit,
- portofol profesional – përshkrim i përvojës organizative dhe i aftësive profesionale.
- të paktën dy mendime/referenca nga partnerët ose donatorët për realizimin e manifestimeve të mëparshme,
- mbështetje me shkrim nga organizata ose institucione të tjera që planifikohet të marrin pjesë në realizimin e manifestimit dhe
- plan marketingu për manifestimin.

7. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

7.1. Për përcaktimin e përmbushjes së kushteve themelore dhe kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e “Festivali Ritmi i çarshisë”, Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizimin e Thirrjes publike për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit “Festivali Ritmi i çarshisë”. (Në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

7.2. Fletë aplikimet që janë të paplota, të dorëzuara jo në afatin e përcaktuar dhe nuk i plotësojnë kushtet në pajtim me nenin 11, të përcaktuara në Rregulloren për mënyrën, kushtet, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e ngjarjeve, festivaleve, manifestimeve, projekteve dhe aktiviteteve projektuese në fushën e zhvillimit lokal ekonomik nr. 08-775/1, të datës 26.01.2026, nga Komisioni i refuzon me Konkluzion.

7.3. Për aplikimet që janë të plota, të dorëzuara në kohë dhe plotësojnë kushtet dhe kriteret, Komisioni jep propozim deri te Kryetari i Qytetit të Shkupit për përzgjedhjen e aplikantit për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e festivalit.

7.4. Kryetari i Qytetit të Shkupit, në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të propozimit të Komisionit, sjell Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e manifestimit "Festivali Ritmi i Çarshisë".

Vërejtje:

- ***Aplikimet me dokumentacion të paplotë ose të dorëzuar pas përfundimit të afatit të parashikuar nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e dorëzuara nuk kthehen.***
- ***Çdo aplikant mund të dorëzojë vetëm një aplikim për Thirrjen publike.***

8. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletë aplikimeve

8.1. Afati për dorëzimin e aplikimeve është 5 ditë nga dita e shpalljes së Thirrjes publike.

8.2. Fletë aplikimi me dokumentacionin e plotë duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për Zhvillim ekonomik lokal, bul. “Ilinden” nr.82, 1000 Shkup** (me shënimin - Sektori për Zhvillim ekonomik lokal – Aplikim për thirrjen publike për ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e “Festivali Ritmi i çarshisë”).

8.3. Aplikantët e thirrjes publike do të njoftohen për rezultatet brenda 15 ditëve nga dita e përfundimit të Thirrjes publike.

8.4. Dokumentacioni i plotë, fletë aplikimi për mbështetje financiare, përmbajtja, kushtet dhe kriteret themelore/të veçanta (shtojca të fletë aplikimit) dhe plani financiar për projektin mund të merren në hapësirat e Qytetit të Shkupit, Sektori për

zhvillim ekonomik lokal, baraka nr.6, zyra çdo ditë pune si dhe në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit : www.skopje.gov.mk.

8.5. Pyetjet për sqarime plotësuese mund të parashtrohen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Sektorit për zhvillim ekonomik lokal.

Tel. kontaktues: (02)3297-284 dhe e-mail adresa: Rukije.Zekiri@skopje.gov.mk ;

QYTETI I SHKUPIT